

Tirane me: 8 Shkurt 2022

Drejtuar: Znj. Naureda Llagami
Kryetare
Këshilli i Lartë Gjyqësor

Ne vemendje të: Z. Ulsi Manja
Ministër
Ministria e Drejtësisë

Lënda: Opinion mbi Hartën e Re Gjyqësore të prezantuar nga KLGJ më 28 dhjetor 2021

Opinion mbi Hartën e Re Gjyqësore të prezantuar nga KLGJ më 28 dhjetor 2021

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 135 rendit tri nivele gjykatash që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin shqiptar: Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj. Po në këtë nen në pikat vijuese, parashikohet krijimi i gjykatave të posaçme dhe gjykata të tjera për fusha të veçanta, por në asnjë rast gjykata të jashtëzakonshme, që gjithashtu krijohen me ligj. Aktualisht, në territorin shqiptar kemi 29 gjykata të shkallës së parë, ndër të cilat 22 janë gjykata rrethi me juridiksion të përgjithshëm, 6 gjykata administrative, 1 gjykatë e posaçme; 8 gjykata apeli, ku 6 janë gjykata apeli me juridiksion të përgjithshëm, 1 gjykatë administrative, 1 gjykatë e posaçme; dhe 1 Gjykatë të Lartë.¹

Ligji 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (Ligji 98/2016), një ndër ligjet e paketës së reformës në drejtësi, në kuadër të synimit për rritjen e pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe përmirësimit të cilësisë dhe efijencës së shërbimeve gjyqësore, ndër të tjera parashikon se Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë përgatit një propozim të përbashkët për hartën e re gjyqësore, i cili

¹ Një Hartë e re gjyqësore për Shqipërinë, Raport vlerësimi nga KLGJ, shtator 2021, e aksesueshme: <http://klgj.al/wp-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>, f. 3.

miratohet më pas nga Këshilli i Ministrave.² Pasi miratohet harta e re gjyqësore mund të rishikohet në bazë të një vlerësimi të organizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave të paktën çdo pesë vjet.³

Projekt propozimi i Hartës së Re Gjyqësore

Pas një pune dy vjeçare dhe pesë vite pas miratimit të paketës së ndryshimeve të reformës në drejtësi, më 28 dhjetor 2021, KLGJ prezantoi projekt propozimin e përbashkët me Ministrinë e Drejtësisë për Hartën e Re Gjyqësore.⁴ Në këtë projekt KLGJ propozon që⁵:

- 22 gjykatat e rretheve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm të riorganizohen në 12 gjykata;
- 6 gjykatat administrative të shkallës së parë të riorganizohen në 2 gjykata; dhe
- 6 gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm në 1 gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm.

Në këtë projekt propozim mbeten të pandryshuara nga rishikimi i Hartës së re Gjyqësore gjykatat:

- 1 gjykatë e Apelit Administrativ
- 1 gjykatë e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
- 1 gjykatë e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
- 1 Gjykatë e Lartë

Vlerësimi i organizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave (harta gjyqësore) është një ndër çështjet më të rëndësishme që zgjidh KLGJ. Procesi për caktimin ose caktimin rishtas të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave duhet të kryhet në mënyrë transparente, duke u bazuar në vlerësimin e plotë të situatës dhe duke marrë në konsideratë objektivat, parimet dhe kriteret e përcaktuara në ligji, dhe nevojën për vazhdimësi të shërbimeve gjyqësore, transferimin e personelit dhe organizimin e logjistikës.

Në nenin 14 të Ligjit 98/2016 është përcaktuar se kompetencat tokësore të gjykatave caktohen duke synuar përmbushjen në mënyrë të ekuilibruar të objektivave të mëposhtëm:

- a) garantimin e aksesit në drejtësi, që lidhet me afërsinë e individit me gjykatën;
- b) uljen e kostove, me qëllim përdorimin me efektshmëri të burimeve publike;
- c) rritjen e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve të ofruara.

² Neni 13, Ligji 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

³ Neni 13 pika 1, Ligji 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

⁴ Një Hartë e re gjyqësore për Shqipërinë, Raport vlerësimi nga KLGJ, shtator 2021, e aksesueshme: <http://klgj.al/wp-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>

⁵ Shih Një Hartë e re gjyqësore për Shqipërinë, Raport vlerësimi nga KLGJ, shtator 2021, e aksesueshme: <http://klgj.al/wp-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>.

Ndër të tjera, Ligji 98/2016 në nenin 15, ka përcaktuar dhe parimet dhe kriteret e nevojshme që duhet të merren parasysh për përcaktimin e kompetencave tokësore të gjykatave. Këto kriteret kanë të bëjnë me:

- Ndarjen administrative territoriale të vendit;
- Ngarkesën e gjykatave;
- Eficiencën e gjykatave;
- Burimet njerëzore në dispozicion;
- Zhvillimin demografik;
- Zhvillimin ekonomik;
- Infrastrukturën në gjykata si dhe vendndodhjen e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

Në këtë kuadër harta gjyqësore përbën një ndër çështjet me të rëndësishme të sigurimit të efektshmërisë dhe cilësisë së gjykatave.

Harta e re gjyqësore e propozuar nga KLGJ në dhjetor 2021, vjen pas një analize të gjendjes së gjykatave dhe pas evidentimit të praktikave më të mira të disa shteteve europiane. Nga leximi i *Raportit të Vlerësimit nga KLGJ 'Një hartë të re gjyqësore për Shqipërinë'*, kuptojmë se reduktimi i gjykatave të rretheve gjyqësore të shakllës së parë, atyre administrative dhe gjykatave të apeleve, përveçse është synuar të ndjekë praktikën europiane, vë në dukje dhe një sërë elementësh të një karakteri objektiv si dhe në zbatim të Ligjit 98/2016, neni 15 pika 4, ku parashikohet se gjykata e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm dhe administrativ duhet të ketë së paku shtatë gjyqtarë, ndërsa gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ së paku 10 gjyqtarë. Aktualisht në organikën e disa gjykatave numri i gjyqtarëve është me i ulët sesa minimumi që parashikon ligji. Po ashtu është analizuar se aktualisht ekziston një mospërputhje midis gjyqtarëve të cilët ushtrojnë funksione në gjykatat e shkallës së parë në raport me çështjet civile, penale dhe administrative që kanë në shqyrtim, në raport me numrin e çështjeve mesatare në rang kombëtar. Ky raport është⁶:

- 429 çështje për gjyqtar në gjykatat e rretheve gjyqësore;
- 378 çështje për gjyqtar në gjykatat e shkallës së parë administrative;
- 217 çështje për gjyqtar në gjykatat e apeleve.

Pra për rrjedhojë të analizës së bërë, KLGJ propozon hartën e re gjyqësore me:

- 12 gjykata të rretheve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm;
- 2 gjykata administrative të shkallës së parë;
- 1 gjykatë e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- 1 gjykaktë apeli të juridiksionit të përgjithshëm;
- 1 gjykatë apeli administrative;
- 1 gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; dhe
- 1 Gjykatë e Lartë.

⁶ Ngarkesat mesatare kombëtare me çështje, të përdorura, Një Hartë e re gjyqësore për Shqipërinë, Raport vlerësimi nga KLGJ, shtator 2021, e aksesueshme: <http://klgj.al/wp-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>, f.21.

Dobitë dhe problematikat që sjell Harta e Re Gjyqësore: çështje që duhen pasur në vëmendje

Harta gjyqësore nuk duhet konceptuar vetëm si një shpërndarje e gjykatave në terma gjeografikë, përkundrazi është shumë më tepër se vetëm shpërndarje territoriale. Gjykatat janë organet që japin drejtësi dhe si të tilla duhet të jenë sa më pranë qytetarëve në mënyrë që drejtësia si një ndër të drejtat më të rëndësishme të njeriut të jetë e aksesueshme për të gjithë.

Harta e re gjyqësore e propozuar nga KLGJ ka analizuar aksesin në drejtësi duke e baraspeshuar me treguesit e performancës, treguesit për distancën dhe kohën e udhëtimit (*tregues që mat distancën që i duhet qytetarit për të aksesuar gjykatën brenda një rrethi gjyqësor*); tregues për ngarkesën e punës dhe nevojën për gjyqtar si dhe tregues për numrin e gjyqtarëve për sallë gjyqi. Bazuar në këto tregues, KLGJ ka dalë me propozimin për hartën e re gjyqësore. Ky propozim në tërësinë e tij sjell një qasje pozitive, pasi ulja e numrit të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm bazuar në analizën e treguesëve të lartpërmendur, pritët të sjellë rritje të cilësisë së vendimmarrjes, shpërndarje më të mirë të kohës gjyqësore, shërbime të përmirësuara, reduktim vonesash në procedurat gjyqësore dhe kohën e gjykimit (duke kujtuar dhe vonesat që krijohen në formimin e trupave gjyqësore në ata gjykata të cilat nuk kanë numër të mjaftueshëm gjyqtarësh). Edhe në rastin e propozimit të një gjykate apeli të juridiksionit të përgjithshëm, KLGJ paraqet argumenta që fokusohen në rritjen e cilësisë së shërbimit, gjykim rishikues brenda afateve, efikasitet dhe paanshmëri.

Pavaresisht analizës së detajuar që u është bërë disa çështjeve dhe treguesve në Raportin e Vlerësimit nga KLGJ, nuk del qartë sesi pritët të implementohet ky propozim, i cili aktualisht është në fazën e konsultimit publik me gjykatat dhe grupet e interesit.

Nëse kjo hartë e re gjyqësore do të miratohet kështu siç është propozuar, një sërë problematikash ngrihen për diskutim. Në vijim do të fokusohemi kryesisht në problematikat që kanë të bëjnë me aksesin në drejtësi të përdoruesve të gjykatës.

Raport Vlerësimi nga KLGJ i ka kushtuar një pjesë të rëndësishme analizës së aksesit në drejtësi. Përsa i përket distancës për kohën e udhëtimit për të aksesuar gjykatën brenda rrethit gjyqësor ku qytetari bën pjesë, Raporti përpiket të ruajë si standard për kohëzgjatjen e udhëtimit: 2 orë. Në pamje të parë dhe në zbatim të kriterëve objektivë, bazuar në tregues të mirëstudiuar edhe ndërkombëtarisht, duket se distanca kohore prej 2 orësh (në ndonjë rast edhe 2 orë e 30 min) është e pranueshme dhe optimale. Por ky është vetëm një element që po të përkthehet në realitetin shqiptar tregon pamundësinë e përdoruesëve të gjykatave për të marrë shërbim. Kjo pamundësi që në pamje të parë i atribuohet distancës kohore lidhet me një sërë faktorësh që janë:

- infrastrukturorë (*në Raport Vlerësim nuk analizohet nëse transporti publik ofrohet në çdo zonë të Shqipërisë dhe nëse çdo qytetar kudo që ndodhet të ketë mundësi që të përdorë transportin publik për të shkuar dhe për tu kthyer nga gjykata*),
- ekonomikë (*në Raport Vlerësim nuk analizohen kostot e transportit dhe mundësitë ekonomike të përdoruesëve të gjykatave për të përballuar kosto të tilla*),

- ndërgjegjësim (*Raporti Vlerësues nuk analizon hapat që do të merren për t'i njohur përdoruesit e gjykatave me ndryshimet e propozuara dhe sesi kjo gjë mund të sjellë përmirësimin e drejtësisë që ata do të marrin*).

Përveç shqetësimit për aksesin në drejtësi të qytetarëve dhe problematikave që sjell harta e re gjyqësore në këtë drejtim, po ta zbrisim propozimin në aktualitetin shqiptar, një tjetër element që na shqetëson është dhe infrastruktura e gjykatave. Me këtë infrastruktura që kanë gjykatat shqiptare aktualisht, duke menduar dhe shkrirjet e gjykatave të propozuara nga KLGJ, pra gjykata më të mëdha, lindin pyetjet se si do të ruhet solemniteti i gjykimit, si do të organizohen seancat në sallë, seancat publike me regjistrim, si do të mundësohet një gjë e tillë?

Me hartën e re gjyqësore të propozuar nga KLGJ biem dakord për atë që analizojmë, se reduktimi i numrit të gjykatave, pra gjykata më të mëdha, por më të pakta në numër sjellin avantazhe, bazuar kjo dhe në përvojat Europiane, por analiza nuk merr në shqyrtim se si do të realizohet konkretisht një reduktim i tillë i gjykatave dhe pasojat që do të sjellë. Raporti Vlerësues⁷ i përmend përvojat Europiane dhe reformat e hartës gjyqësore që janë ndërmarrë në disa vende, si dhe rezultatin pozitiv që kanë pasur, por nuk ndalet në kuptimin e mësimave që mund të merren nga këto përvoja. Një ndër mësimet më të rëndësishme që këto përvoja europiane japin është shtrirja kohore e këtyre reformave. Hollandës iu deshën 13 vite për të pasur hartën gjyqësore që ka sot, Suedisë iu deshën rreth 20 vite.

Po Shqipërisë sa kohë i duhet për të pasur hartën e re gjyqësore të propozuar në dhjetor 2021?

Pra nëse harta e re gjyqësore do të miratohet siç është propozuar, çështja që duhet ngritur është si do të shkojmë aty. Nëse shkrirja e gjykatave të vogla dhe formimi i gjykatave të mëdha siç parashikohen në hartën e re gjyqësore do të ndodhë 'sot për nesër' mund të sjellë dëme të parikuperueshme. Ndaj dhe është e rëndësishme të parashikohet një periudhë tranzitore brenda së cilës do të ndodhë ky ndryshim dhe hapat konkretë që do të ndërmerren. Kjo gjë mund të bëhet duke pasur në vëmendje së paku disa çështje si në vijim:

- *aksesi në drejtësi i qytetarëve*

Harta e re gjyqësore e propozuar nga KLGJ për shkak se propozon shkrirjen e disa gjykatave, largon qytetarin nga aksesimi i tyre, kjo dhe për shkak që u shpjeguan më lart. Për rrjedhojë, një plan më konkret për afrimin e organeve të drejtësisë tek qytetarët p.sh me anë të degëve të gjykatave mund të shqyrtohet. Ligji 98/2016, lejon krijimin e degëve të gjykatave. Duke pasur parasysh faktorët infrastrukturorë dhe ekonomikë të përmendur më lart, krijimi i degëve të gjykatave mund të ndihmojë për të mos çënuar aksesin në drejtësi të qytetarëve. Praktikant nga vendet europiane kanë treguar se degët e gjykatave në disa raste kanë qenë të nevojshme, në disa të tjera kanë pasur kosto më të larta sesa përfitimet që kanë sjellë. Në rastin tonë nuk kemi analizë të impaktit të degëve të gjykatave por vetëm mund të bazohemi në eksperiencën e vendeve të tjera si dhe në udhëzimet e Komisionit Europian të Këshillit të Europës, për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ)⁸:

⁷ Shih Një Hartë e re gjyqësore për Shqipërinë, Raport vlerësimi nga KLGJ, shtator 2021, e aksesueshme: <http://klgj.al/wp-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>, f. 7-10.

⁸Udhëzime të Rishikuara për Krijimin e Hartave Gjyqësore për të mbështetur Aksesin në Drejtësi brenda një Sistemi Gjyqësor cilësor, CEPEJ (2013) 7, Rishik. 1, f. 41.

“A duhet që të gjitha shërbimet e ofruara brenda një gjykate të mbesin brenda gjykatës kryesore? A kemi nevojë për praninë e plotë fizike të një gjykate, edhe nëse ajo çka duhet të bëjnë shumica e klientëve është të mbledhin një formular ose thjesht të dorëzojnë dokumentacionin për të nisur procedimet e tyre? Mund të jetë e dobishme që të përcaktohen pikat e mbështetjes për detyrat administrative, ...”

Për rrjedhojë mund të themi se degët e gjykatave mund të jenë pjesë e një qasje tranzitore. Pra, një zgjidhje mund të jetë që, në vendet ku janë gjykatat e vogla, të ngrihen degë apo pika mbështetëse për veprimet me natyrë administrative të gjykatave. Ligji 98/2016 nuk parashikon rregulla nëse një gjykatë mund të ushtrojë funksionin e saj në më shumë vende ose jo. Në mbështetje të pohimit ligjor *a maiore minus*, Ligji 98/2016 nuk e përjashton një gjë të tillë. Kështuqë, veprime të tilla si depozitimi i padive, kërkesave, ankimeve, provave, marrja e njoftimeve, nuk janë të nevojshme për ta çuar përdoruesin në ambientet e gjykatës por mund të kryhen në këto pika mbështetëse të gjykatës që janë më pranë qytetarit.

Gjithsesi duhet qartësuar nëse do të ngrihen degë apo pika mbështetëse si dhe dallimet dhe rastet kur mund të dorëzohen paditë dhe dokumentacioni, si dhe nëse mund të marrin pjesë palët në seanca, pra sipas nenit 17 pika 1 të Ligjit 98/2016, “një gjykatë e cila ushtron funksionet e saj në dy (ose më shumë) vendndodhje”. Në këtë mënyrë, një degë gjykate duket se kërkon të paktën praninë e pjesshme të një gjyqtari, duke pasur parasysh se një ndër funksionet e një gjykate është gjykimi përmes pranisë së gjyqtarëve. Pra, kjo është një çështje që kërkon një propozim konkret që merr në konsideratë të drejtën e patjetërsueshme të qytetarëve për akses në drejtësi.

- infrastruktura e gjykatave

Për tu implementuar harta e re gjyqësore ashtu siç është propozuar, duhen marrë në konsideratë dhe të analizohen kostot që kërkon infrastruktura e nevojshme që do të siguronte jo vetëm akses në drejtësi por edhe solemnitetin e gjykatës. Parashikimet se kur mund të bëhet e mundur një gjë e tillë mungojnë. Raporti i Vlerësimit nuk merr në analizë nëse gjykatat e mëdha që do të krijohen nga shkrija e gjykatave mund t’i ofrojnë kushtet optimale për realizimin e seancave gjyqësore publike, sipas standardeve dhe siç i kërkon ligji, pa shkaktuar vonesa apo mbivendosje gjyqesh në të njëjtën sallë. Problematika të tilla hasen aktualisht në gjykatat me fluks të madh çështjesh, ndaj nëse nuk mendohet për të përmirësuar dhe zgjidhur çështjen e infrastrukturës së gjykatave, probleme të tilla mund të shtohen.

- rritja e kapacitetit të gjykatave

Raporti i vlerësimit nga KLGJ analizon se harta e re gjyqësore do të sjellë efekte pozitive në cilësinë e dhënies së drejtësisë dhe ofrimit të shërbimeve por nuk evidenton sesi do t’i përgjigjen kapacitetet e gjykatave fluksit të çështjeve të reja apo të prapambetura. Në Shqipëri, fluksi i çështjeve të reja nuk vërehet të ketë ndryshuar, po ashtu dhe çështjet e prapambetura zënë një numër të konsiderueshëm. Ndaj dhe përbën shqetësim fakti nëse gjykatat që do të krijohen sipas hartës së re gjyqësore do të mund të përballojnë siç duhet fluksin e çështjeve të reja dhe atyre të prapambetura për të dhënë drejtësinë në kohë dhe cilësore. Procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ka krijuar vakanca në sistem, gjë që ka ndikuar në shtimin e çështjeve të prapambetura dhe në uljen e cilësisë së gjykimit. Po ashtu, në gjykata vërehet

mungesë e stafit ndihmës, sikurse janë ndihmësit dhe këshilltarët ligjorë si dhe mungesa e trajnimeve vazhduese për administratën e gjykatave. Ndaj dhe rritja e kapaciteteve të gjykatave por edhe e zyrave të prokurorive, me staf mbështetës dhe të trajnuar është një domosdoshmëri. Administrimi i mirë i gjykatës dhe zyrës së prokurorisë si dhe shtimi e kualifikimi i stafit mbështetës mund të rrisë efektivitetin e gjykatës në dhënien e shqërbimit për qytetarët, sidomos në këtë fazë ku largimet e magjistratëve nga procesi i rivlerësimit janë më të mëdha sesa prurjet nga Shkolla e Magjistraturës.

- *teknologjia e informacionit*

Përdorimi i teknologjisë së informacionit mund të sjellë lehtësira për përdoruesit e gjykatës, si dhe do të sjellë ndikim pozitiv jo vetëm në aksesin e individit në gjykatë, por edhe në cilësinë e vendimarrjes, në vizibilitetin dhe transparencën e saj dhe uljen e kostove të proceseve gjyqësore si për individin, edhe për gjykatën.

Seancat dëgjimore në distancë të zhvilluara në disa gjykata gjatë pandemisë së shkaktuar nga COVID-19⁹ përdorën me sukses teknologjinë duke reduktuar praninë fizike të palëve ndërgjyqëse, avokatët dhe të stafit të gjykatës. Ky model, i paraqitur në periudhën e COVID-19, mund të shërbejë si model për organizimin e seancave në distancë në degët e gjykatave, gjë që do të zbuste ndjeshëm çdo afektim të mundshëm të aksesit në drejtësi: palëve nuk do t'u duhet të udhëtojnë (larg) dhe seancat në distancë zhvillohen vetëm nëse të gjitha palët japin pëlqimin e tyre¹⁰.

Po ashtu, Ligji nr. 9705, i datës 21.3.1995, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar parashikon se i pandehuri mund të marrë pjesë në një seancë me anë të mjeteve audio/video, kur ai/ajo me sjelljen e tij/saj ka penguar kryerjen e rregullt të seancës¹¹. Ndërkohë, Ligji nr. 8116, i datës 29.03.1996, Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar parashikon se në paditë me shuma të vogla deklaratat e dëshmitarëve mund të merren me anë të video konferencës jashtë mjediseve të gjykatës¹².

Pra teknologjia e informacionit përbën një mjet që ofron shumë zgjidhje. Paisja e gjykatave me shërbimet bashkëkohore të teknologjisë së informacionit si dhe hartimi i një plani të mirëmbësues për shërbimet e teknologjisë së informacionit që mund të ofrojnë gjykatat dhe degët e gjykatave apo sesi mund të aksesohen nga qytetarët (duke pasur në vëmendje edhe ata të cilët nuk kanë akses në pasisje teknologjike) mund të përshpejtojë tranzicionin dhe lehtësojë implementimin e hartës së re gjyqësore.

⁹ Akti Normativ "Për disa ndryshime në Aktin Normativ nr. 9, të datës 25.3.2020 'Për marrjen e masave të posaçme në fushën e aktivitetit gjyqësor gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19', miratuar me anë të ligjit nr. 30/2020", parashikon mundësinë e pjesëmarrjes në distancë në seancat dëgjimore, të çdo pale në procedura (duke përfshirë palën e tretë; dëshmitarët; ekspertët etj.), të cilat i nënshtrohen marrëveshjes së palëve në çështje (palët në çështje janë i pandehuri/prokurori në çështjet penale, ose paditësi dhe i padituri në çështjet civile dhe administrative). Gjithashtu, Akti Normativ parashikon mundësinë për të paraqitur dokumente/akte procedurale si elektronikisht edhe me anë të postës rekomande.

¹⁰Akti Normativ nr. 9, i datës 25 mars 2020, Neni 4, paragrafi 1

¹¹Neni 344 i KPP.

¹²Neni 236/a i KPC

- *përdoruesit e gjykatave*

Një ndër treguesit më të rëndësishëm të matjes së performancës së gjykatave dhe të gjyqësorit në përgjithësi është niveli i kënaqësisë së përdoruesëve të gjykatave kundrejt ofrimit të shërbimit nga gjykata. Reduktimi i gjykatave, në mënyrë që mos cenojë të drejtën e qytetarëve për akses në drejtësi dhe marrjen e drejtësisë pa vonesa duhet bërë në mënyrë graduale dhe të mirëmeneduar. Ndaj dhe institucionet përkatëse shtetërore duhet të koordinohen dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme që qytetarët të mos cenohen nga harta e re gjyqësore por të marrin shërbime sa më cilësore dhe pa vonesa. Për të arritur këtë, përveç sa thamë më lart, edukimi ligjor i publikut ka një rëndësi të veçantë. Një tërësi çështjesh mund të zgjidhen jashtë dyerve të gjykatës, me ndërmjetësim apo dhe çështje që kanë të bëjnë me qeverisjen vendore. Ndër të tjera edukimi ligjor i publikut mund të çojë dhe në uljen e konflikteve dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së qytetarëve. Edukimi ligjor i publikut është dhe ndërgjegjësim, për të bërë me dije qytetarët për të drejtat e tyre, shërbimet që shteti ofron (si p.sh. ndihma juridike parësore dhe dytësore) dhe mënyrën sesi mund të aksesohen këto shërbime. Ndërgjegjësimi dhe edukimi ligjor i publikut (për këtë ekziston dhe Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023¹³) është një komponent kyç për një qasje të plotë ndaj shërbimeve ligjore si dhe mund t'i pajisë qytetarët me njohuri dhe aftësi për të menaxhuar më mirë problemet e tyre dhe për të kuptuar se kur duhet t'i drejtohen gjykatës. Pra harta e re gjyqësore duhet të fokusohet para së gjithash tek përdoruesit e gjykatave – qytetarët – për të analizuar nëse janë gati qytetarët për të mirëpritur këtë propozim të hartës gjyqësore.

Përfundime dhe rekomandime

Harta e re gjyqësore e propozuar nga KLGJ vjen në kuadër të frymës që sjell reforma në drejtësi dhe synon përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve gjyqësore. Por implementimi i kësaj harte për të qenë efikas dhe për të mos cënuar të drejtën themelore të qytetarit për drejtësi, duhet të bëhet gradualisht dhe në mënyrë të mirëstudiuar e mirëplanifikuar. Duke marrë parasysh situatën aktuale të vendit, infrastrukturën e gjykatave, mundësitë reale të qytetarëve për të aksesuar organet e drejtësisë si dhe të drejtën e gjithësecilit për të qenë të barabartë përpara ligjit dhe aksesit në drejtësi, kësaj harte të re gjyqësore duhet t'i bashkëlidhet një plan implementimi me afate kohore dhe hapa konkretë që do të ndërmerren për vënien në zbatim të saj.

Në këtë kuadër rekomandimet e mëposhtme synojnë të risjellin edhe një herë në vëmendje problematikat e projekt propozimit të hartës së re gjyqësore si dhe të sugjerojnë çështje që duhen mbajtur parasysh:

1. Së pari duhet të sigurohemi që nuk cenohet parimi i krijimit të aksesit në drejtësi, si për gjykatat e shkallëve të para ashtu dhe për gjykatat e apelit.
2. Duhet mbajtur parasysh popullsia e rajoneve apo rretheve gjyqësore ekzistuese të cilat janë menduar të shpërndihen në rrethe me shtrirje më të gjerë gjeografike. Këtu duhet

¹³ Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023, e aksesueshme:
<https://www.parlament.al/Files/Akte/20190424122731vendim%20nr.%2047,%20dt.%2018.4.2019%20-Teksti%20i%20Strategjiise.pdf>

vleresuar edhe fluksi i turizmit apo përqendrimin të popullsisë në sezone të caktuara, si dhe trendi i ngarkesës me çështje të të gjitha kategorive.

3. Duhet mbajtur parasysh trendet e zhvillimit ekonomik të secilit rajon dhe parashikimi i ecurisë së aktiviteteve ekonomike, sociale dhe të zhvillimit kompleks të këtyre zonave.
4. Duhet mbajtur parasysh cilësia e infrastrukturës, hekurudhore dhe automobilistike si dhe kostot kohore dhe financiare të transportit nga zonat më të thella në drejtim të gjykatave.
5. Duhet mbajtur parasysh shtrirja e aplikimit të ADR/ mekanizmave të zgjidhjes së konflikteve në rrugë jashtëgjyqësore (ndërmjetësim, arbitrazh) në rrethet periferike dhe në të gjithë vendin.
6. Duhet mbajtur parasysh cilësia dhe niveli i aplikimit të teknologjisë së informacionit në veprimtarinë e gjykatave, si një mjet i cili mund të lehtësonte aksesin e qytetarëve në gjykatë.
7. Duhet mbajtur parasysh edhe shtrirja dhe cilësia e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike falas. Kjo duke pasur parasysh që sa më i vështirë të jetë aksesin në gjykata, aq më shumë duhet të shtohet ofrimi i ndihmës juridike nga shteti.
8. Duhet mbajtur parasysh dhe stafet e gjykatave që do të mbeten pas reformës, pra gjykatat që përfshijnë një territor më të gjerë. Këto gjykata duhet të kenë organika të plota me gjyqtar të kualifikuar, por edhe ndihmës gjyqësor si dhe staf administrativ gjyqësor të mjaftueshëm për të përballuar në mënyrë efikase ngarkesën e shtuar.